



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 18 AKTI

NR. 56 VENDIMI

Tiranë, më 01.08.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Suela Zhegu	Anëtar
Genta Tafa(Bungo)	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo, më datë 31.07.2018, ora 9:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i dytë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Dritan Hallunaj**, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE : **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (referuar më poshtë “Kushtetuta”).

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar më poshtë ligji nr. 84/2016);

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, atë pasuror, të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Hallunaj, ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit Dritan F. Hallunaj, duke qenë se ka kandiduar për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në bazë të nenit 276 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më datë 30.11.2017 në përputhje me “Rregullore për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në referim të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar menjëherë, pasi janë caktuar me short trupat gjykuese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe është shortuar shpërndarja e çështjes konkrete, më datë 30.11.2017.

Në mbledhjen e trupit gjykuese të datës 14.12.2017 u caktua me mirëkuptim kryesuesi i trupit gjykues, Znj. Pamela Qirko. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës gjykuese, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

Inspektoriati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 09.11.2017, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- 1) *Deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- 2) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- 3) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- 4) *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- 5) *Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me atë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontaktet të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Hallunaj.*

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 16.01.2018.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 11.07.2018, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit, më datë 12.07.2018. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes më datë 17.07.2018 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më datë 24.07.2018.

Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, më datë 27.07.2018.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 31.07.2018, ora 9:00, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Z. John Leonardo.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojti personalisht, shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Dritan Hallunaj ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikmëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) Provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) Deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) Shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit;
- dh) Deklarimet e personave të tjerë të lidhur.

Në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 20.01.2017, **subjekti deklaron këto pasuri** (të paluajtshme dhe të luajtshme) në emër të tij:

1. Apartament, me sipërfaqe 165 m², ndodhur në Rr. ***, blerë në shumën 49.000 euro, sipas kontratës së porosisë me nr. *** rep., datë 29.12.2005, lidhur midis “***” me përfaqësues z. R.P dhe subjektit z. Dritan Hallunaj.

Burimi i deklaruar i krijimit sipas “Deklaratës së Pasurisë, Vetting”:

Kredia e marrë në vlerën 5.000.000 lekë dhe kursimet familjare.

Në lidhje me këtë apartament, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Kopje të njehsuar me origjinalin të:
 - Kontratë porosie, nr. *** rep., datë 29.12.2005.
 - Kontratë kredie bankare, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.12.2015.
 - Kontratë hipoteke, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.12.2015.
- Dokumente në origjinal si më poshtë:
 - Vërtetim, datë 13.01.2017, lëshuar nga “Raiffeisen Bank”.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

- Shkresë nr. *** prot., datë 21.12.2017, drejtuar ZVRPP-ja Tiranë e cila i është dërguar dhe ZQRPP.

ZQRPP me shkresë nr. *** prot., datë 27.12.2017, ia ka deleguar të gjitha ZVRPP-ve.

- Shkresë nr. *** prot., datë 3.01.2018, dërguar ZVRPP-ja Tiranë.

Me shkresë nr. *** prot., datë 11.01.2018, ZVRPP-ja Tiranë na informon se: *Nga ana e shoqërisë “***” nuk ka asnjë regjistrim të lejes së ndërtimit nr. ***, datë 09.09.199, si dhe të godinës së banimit të ndërtuar nga ana e kësaj kompanie.*

- Shkresë nr. *** prot., datë 03.01.2018, drejtuar ALUIZNI.

Me shkresë nr. *** prot., datë 11.01.2018, ALUIZNI, na informon se: *Z. R.P ka aplikuar në procesin e legalizimeve.*

- Shkresë nr. *** , datë 01.02.2018, drejtuar Drejtorisë së ALUIZNI-t TIRANA 2.

Me shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, Drejtoria e ALUIZINI-t TIRANA 2 na informon se: *Z. R.P ka aplikuar për legalizimin e tri kateve + papafingo.*

- Shkresë nr. *** , datë 21.12.2017, drejtuar noterit publik, znj. L.K.

Me shkresën datë 26.12.2017, noteri publik, z. Gj.K na vë në dispozicion kontratë sipërmarrjeje/porosie të lidhur midis “***” dhe z. Dritan Hallunaj.

- Shkresë nr. *** prot., datë 21.12.2017, drejtuar 27 bankave dhe institucioneve të tjera financiare.

Shkresë nr. *** prot., datë 26.12.2017, kthim përgjigje “Raiffeisen Bank”.

- Shkresë nr. *** prot., datë 03.01.2018, drejtuar “Raiffeisen Bank”.

Me shkresë nr. *** , datë 09.01.2018, “Raiffesien Bank” na vë në dispozicion dokumentacionin e dorëzuar nga ana e subjektit të rivlerësimit për marrjen e kredisë.

- Shkresë nr. *** prot., datë 21.02.2018, drejtuar shoqërisë “***”.

Shkresë nr. *** prot., datë 27.02.2018, kthim përgjigje i shoqërisë “***”.

- Shkresë nr. *** prot., datë 12.02.2018, drejtuar shoqërisë “***”.

Shkresë nr. *** prot., datë 12.02.2018, kthim përgjigje i shoqërisë “***”.

- Shkresë nr. *** prot., datë 03.01.2018, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Me shkresë nr. *** prot., datë 10.01.2018, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, na informon se nuk disponon praktikën e trajtimit më kredi të subjektit të rivlerësimit.

- Shkresë nr. *** prot., datë 03.01.2018, drejtuar Ministrisë së Financave.

Me shkresë nr. ***prot., datë 16.01.2018, Ministria e Financave na vë në dispozicion marrëveshjen, nr. 3232/2 prot., datë 26.05.2005, “Mbi kreditimin nga RBAL të nevojave për strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”.

- Shkresë nr. *** prot., datë 12.01.2018, drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Me shkresën nr. ***prot., datë 29.01.2018, KLD-së na informon se nuk disponon praktikën e trajtimit më kredi të subjektit të rivlerësimit.

- Shkresë nr. *** prot., datë 07.02.2018, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

Me shkresë nr. ***prot., datë 07.03.2018, Ministria e Drejtësisë na informon se nuk rezultojnë të ketë dokumentacion të dërguar nga ana e subjektit të rivlerësimit.

- Shkresë nr. *** prot., datë 08.02.2018, drejtuar “Raiffeisen Bank”.

Me shkresë nr. ***prot., datë 16.02.2018, “Raiffeisen Bank” na informon se institucioni që paguan interesin në vlerën 9% të kontratës së kredisë të subjektit të rivlerësimit është Ministria e Financave.

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, drejtuar Ministrisë së Financave.

Me shkresë nr. ***prot., Ministria e Financave ia delegon Entit Kombëtar të Banesave.

Me shkresë nr. ***1 prot., datë 22.02.2018, Enti Kombëtar i Banesave informon se subjekti i rivlerësimit nuk ka përfituar banesë apo kredi nga programet e strehimit që aplikon Enti Kombëtar i Banesave.

- Shkresë nr. *** prot., datë 03.07.2018, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Shkresë nr. *** prot., datë 16.07.2018, kthim përgjigje Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, e cila na vë në dispozicion të dhëna mbi gjëndjen financiare të shoqërisë “***” sh.p.k.

Arsyetimi ligjor:

A. Në vitin 2005, subjekti i rivlerësimit ka porositur tek shoqëria e ndërtimit “***”, me përfaqësues z. R.P, një apartament me sipërfaqe 165 m², të ndodhur në Rr. *** , për shumën prej 49.000 eurosh, me kontratë porosie/ sipërmarrjeje nr. *** rep., datë 29.12.2005. Kjo kontratë është administruar nga ana e Komisionit me shkresë datë 26.12.2017 nga noteri publik, z. Gj.K.

Në nenin 1, paragrafi i parë të kësaj kontrate porosie, parashikohet se: *Sipërmarrësi merr përsipër të ndërtojë një apartament në godinën 8-katëshe dhe t’i dorëzojë porositësit të përfunduar në kullën 8-katëshe, apartamentin në katin e nëntë dhe të dhjetë me sipërfaqe 165 m².*

Në kontratën e lidhur nga ana e subjektit të rivlerësimit parashikohen rrethana të pakuptueshme në lidhje me apartamentin (objektin e kësaj kontrate) pasi nëse i referohemi përmbajtjes së saj ajo është kontradiktore për sa kohë thuhet se sipërmarrësi do t’i dorëzojë porositësit apartament në katin e nëntë dhe të dhjetë të një godine 8-katëshe, pra këto dy kate nuk mund të realizohen fizikisht për sa kohë kemi të bëjmë me një godinë 8-katëshe.

Në lidhje me këtë konstatim subjekti sqaron se në kohën e blerjes së kësaj pasurie, ai ka qenë jashtëzakonisht i ngarkuar në punë dhe njëkohësisht, jetonte sa në Tiranë e në Shkodër. Veç kësaj ka pasur probleme të rënda shëndetësore të nënës së tij duke mos i kushtuar vëmëndjen e duhur dokumentacionit të firmës ndërtuese, ndërkohë që kontratën, e ka nënshkruar tek noteri, i cili e ka garantuar për rregullsinë e saj. Më vonë ka ardhur në dijeni të faktit që leja ishte dhënë për 8 kate, dhe se ky ka qenë problemi që pallati ende nuk është i rregjistruar. Ndonëse ka kërkuar që të prishë kontratën e sipërmarrjes, pas ardhjes në dijeni të problematikës me lejen e ndërtimit, nuk ka mundur të korrigjojë veprimin, sepse firma ndërtuese kishte falimentuar. Apartamenti është blerë si një okazion, pasi personat që ia kishin rekomanduan, i kishin thënë se ndërtuesi kishte probleme financiare. I joshur nga çmimi dhe vendndodhja, ka hyrë në marrëveshje, ndonëse ende, për

probleme të ndërtuesit, apartamenti nuk është regjistruar dhe ai ende nuk është pronar me certifikatë pronësie.

Nga hetimi i kryer nga ana e Komisionit rezulton, që godina në të cilën ndodhet apartamenti nuk është ende e regjistruar në ZVRPP-ja Tiranë, si dhe nuk është bërë as regjistrimi i lejes së ndërtimit të kësaj godine. Nga ana e administratorit të shoqërisë ndërtuese z. R.P është aplikuar pranë ALUZINI-t për legalizimin e tre kateve+papafingo, praktikë e cila është në fazën fillestare të procesit të legalizimit dhe e papërditësuar me dokumentacion nga subjekti deklarues (z. R.P).

Në nenin 1, paragrafi i dytë i kontratës së porosisë, parashikohet se çmimi i blerjes është 49.000 euro ose 300 euro/m² (konvertuar në lekë është 36.600 lekë) vlerë, e cila referuar Udhëzimit nr. 5, datë 23.11.2005, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banësive, dhe të koeficientit "k" për vitin 2005”, rezulton se është më e ulët se vlera e tregut të lirë të apartamenteve në Tiranë në atë zonë.

Në lidhje me këtë konstatim subjektit të rivlerësimit iu kërkua informacion shtesë. Në kthimin e përgjigjes ai sqaron se në sipërfaqen e apartamentit sipas kontratës, janë përfshirë edhe shkallët dhe ambientet e përbashkëta, dhe sipërfaqja e zotërueshme si banesë është më e vogël. Ndërtuesi, duke e ditur problematikën e lejes së ndërtimit për këtë pjesë të banesës, ka ofruar në treg një çmim më të ulët, pa përmendur këtu edhe faktin se ai duhet të këtë qenë në vështirësi financiare në kohën e nxjerrjes në prenotim të këtij apartamenti, fakt që provohet me situatën, që ai së bashku me banorët e tjerë, janë përballur më pas kur ndërtuesi braktisi përfundimin e procedurës për regjistrimin e pallatit dhe të legalizimit që kishte bërë pa lejë, dhe në dijeninë e tij ka kohë që ka ndërprerë çdo aktivitet ndërtues. Madje influenca e çmimit të ulët ishte e tillë, sa që ka ndikuar që të revokojë kontratën e mëparshme të sipërmarrjes, që mban datën 07.12.2005, mes tij dhe kompanisë “***” sh.p.k.

Nga ana e subjektit deklarohet se pikërisht ky çmim ka qenë arsyeja që ka revokuar kontratën me shoqërinë “***”, ndërkohë me shkresën nr. ***, datë 27.02.2018, shoqëria “***” sqaron se pas disa komunikimeve me subjektin, meqënëse shuma nuk u likujdua, palët me mirëkuptim vendosën të revokojnë kontratën e sipërmarrjes.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit, konstatohet se ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën e saj nr. *** prot., datë 11.01.2018, ka dërguar të dhëna të së njëjtës periudhë mbi shitblerje të disa apartamenteve, të ndodhura në rrugën “***”. Nga analiza e këtyre kontratave rezulton se çmimi për m² në atë periudhë, për apartamentet në atë rrugë varion nga 14.606,7 lekë m² në 111.363,6 lekë/m² ndërsa çmimi mesatar është 42.091 lekë/m².

Në përfundim të hetimit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar arsyet e çmimit të blerjes së apartamentit më të ulët se vlera e tregut.

Në datën 24.07.2018, subjekti paraqiti shpjegimet e tij në lidhje me këtë. Ai rikonfirmoi të njëjtin qëndrim mbi arsyet e një çmimi të ulët, si dhe depozitoi provat e mëposhtme:

1. Deklaratën noteriale të shtetasit/sipërmarrësit R.P, me LRP. nr. rend ***, datë 18.07.2018, të bërë përpara noterit A. A., në Republikën e Kosovës. Në këtë deklaratë noteriale, z. R.P konfirmon kontratën e porosisë me nr. *** rep., datë 29.12.2005, të lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë që ai administronte, për blerjen e apartamentit. Sipas përmbajtjes së kësaj deklarate, konfirmohet shpjegimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me problematikën financiare të shoqërisë së ndërtimit “***” sh.p.k., në kohën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, që ka ndikuar në çmimin e ofruar. Sipërmarrësi deklaroi se *“mjetete e inkasuara në atë periudhë nga ana e blerësit, biznesin tim e kanë ndihmuar shumë në vazhdimin e fushëveprimit të biznesit”*. Gjithashtu ai konfirmon edhe faktin se subjekti i rivlerësimit ka tentuar të anulojë kontratën e porosisë disa kohë më vonë, por një gjë e tillë nuk është bërë e mundur.

2. Kontratën e Porosisë me nr. *** rep., nr. *** Kol., datë 08.04.2003, sipas të cilës çmimi i shitjes së apartamentit të ndodhur në të njëjtin pallat, por në pjesën e përfshirë në lejen e ndërtimit, të lidhur ndërmjet administratorit z. R.P dhe porositësit A. B., janë dakordësuar për çmimin prej 450 USD/ m².

3. Bilanci financiar i shoqërisë “***” sh.p.k., dorëzuar në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë, për vitet 2004 - 2005 - 2006.

Duke marrë në konsideratë të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ, duke shqyrtuar provat dhe shpjegimet e subjektit, Komisioni konstaton se subjekti ka përfituar një çmim më të ulët se çmimi i tregut të lirë të apartamenteve, për shkak të tejkalimit të lejes së ndërtimit nga ana e shoqërisë ndërtuese. Nga ana tjetër, duke analizuar bilancet e shoqërisë ndërtuese të paraqitura nga subjekti, konstatohet se shoqëria edhe pse ka dalë me fitim, ka pasur mungesë të theksuar likuiditetesh në datën 31.12.2005. Ndërkohë që detyrimet e kësaj shoqërie janë disa herë më të mëdha se të ardhurat e saj. Nga studimi i dokumentacionit të depozituar nga ZVRPP-ja Tiranë, konstatohet se çmimi i blerjes së apartamentit nga ana e subjektit është afërsisht sa çmimi mesatar i apartamenteve në atë zonë, të shitura në atë periudhë. Komisioni vlerëson se këto argumenta, të bazuara në dokumentacion, vërtetojnë shpjegimet e subjektit, në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit.

B. Bazuar në shkresë nr. ***, datë 09.01.2018, të “Raiffesen Bank”, shuma prej 4.900.000 lekësh, është tërhequr *cash* nga z. Dritan Hallunaj më datë 28.12.2005. Nuk ka asnjë dokument provues që të vërtetohet konvertimi i shumës nga lekë në euro dhe asnjë dokument provues për të vërtetuar dhënien e kësaj shume tek firma “***”.

Në nenin 1, paragrafi 3 të kontratës së porosisë, parashikohet se shuma prej 49.000 eurosh është likuiduar me nënshkrimin e kësaj kontrate.

Nga ana e subjektit të rivlerësimit është depozituar deklarata noteriale e shtetasit/sipërmarrësit z. R.P, me LRP. nr. rend ***, datë 18.07.2018, të bërë përpara noterit A. A., në Republikën e Kosovës, nëpërmjet së cilës ai pranon likuidimin e shumës prej 49.000 eurosh nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Si burim i krijimit të kësaj pasurie është deklaruar kredia e marrë në “Raiffeisen Bank”.

Me shkresë nr. *** prot., datë 03.01.2018, i jemi drejtuar “Raiffeisen Bank” për të marrë të dhëna në lidhje me aplikimin për kredi me kushtet lehtësuese të subjektit.

Me shkresë nr. ***, datë 09.01.2018, “Raiffesien Bank” na vë në dispozicion dokumentacionin e dorëzuar nga ana e z. Dritan Hallunaj për marrjen e kredisë nga ku rezulton se:

Kredia është përfituar me kontratë kredie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.12.2005, vlera e kredisë 5.000.000 lekë, interesi fiks 12% nga ku 3% paguhen nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe 9% nga Ministria e Financave, afati 300 muaj.

Për të mundësuar këtë kredi është lidhur dhe kontrata e hipotekës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.12.2005, nëpërmjet së cilës z. F dhe znj. Sh. H vënë në hipotekë pasurinë nr. *** truall dhe ndërtesë me sipërfaqe 900 m². Referuar kushteve të kësaj kredie, vërehet se kemi të bëjmë me një kredi me kushte lehtësuese të dhënë nga shteti për një kategori të caktuar subjektësh, parashikuar në VKM-në nr. 102, datë 05.03.1999, "Për trajtimin me strehim të të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore".

Në Aneksin 1/B, germa “b” të “Marrëveshjes mbi kreditimin nga RBAL të nevojave për strehim të funksionarëve politikë dhe të nëpunësve civilë administratës së lartë” lidhur midis “Raiffeisen Bank” dhe Ministrisë së Financave, më datë 20.06.2005, përcaktohen dokumentet që kërkohen për blerjen e një apartamenti në ndërtim përpara aprovimit të kredisë si më poshtë:

- Marrëveshje e sipërmarrjes të lidhur midis aplikantit dhe kompanisë së ndërtimit;
- Kopje e lejes së ndërtimit;
- Kopje e certifikatës së pronësisë ku bëhej ndërtimi;
- Aktin noterial midis kompanisë së ndërtimit dhe pronarëve të tokës;
- Certifikatë pronësie e pronës që do të lihet peng përkohësisht në favor të bankës dhe dokumentet e nevojshëm që vërtetojnë origjinën e pronësisë;
- Raportin e vlerësimit.

Referuar shkresës nr. ***, datë 09.01.2018, të “Raiffeisen Bank”, Komisioni konstatoi se në dokumentet e dorëzuar për marrjen e kredisë është dorëzuar një kontratë sipërmarrjeje e ndryshme nga kontrata e porosisë nr. *** rep., datë 29.12.2005, më konkretisht:

Kontratë sipërmarrjeje, datë 07.12.2005, lidhur midis shoqërisë “***” dhe subjektit të rivlerësimit. Autentifikimi i firmës është bërë pranë notere V. S., me nr. *** rep.

Në këtë kontratë parashikohet:

- Objekti: Porositja e një apartamenti me sipërfaqe 104.2 m²;
- Çmimi: 70.000 lek/m², në total 7.294.000 lekë;
- Mënyra e pagesës: Në datën e nënshkrimit të kontratës shuma 2.294.000 lekë;
- Brenda muajit dhjetor 2005 shuma 5.000.000 lekë.

Bazuar në këtë kontratë rezulton se subjekti i rivlerësimit duhet t’i kishte paguar shumën prej 2.294.000 lekësh firmës “***”, shumë të cilën, bazuar në deklaratat periodike të interesave private, nuk e ka patur gjendje.

Për të marrë një informacion më të detajuar për kontratën e depozituar nga ana e subjektit të rivlerësimit pranë “Raiffeisen Bank” i është kërkuar informacion firmës së ndërtimit “***”.

Me shkresë nr. *** prot., datë 14.02.2018, firma na informon se kontrata e sipërmarrjes e datës 07.12.2018 është revokuar nga palët më datë 27.12.2005. Gjithashtu firma na informon se nuk ka pasur asnjë likuidim nga ana e subjektit të rivlerësimit si dhe konfirmon se kontrata e dorëzuar prej saj është e njëjtë me atë të dorëzuar pranë noterit V. S.

Kontrata e sipërmarrjes e lidhur me “***” sh.p.k., është përdorur si dokument zyrtar nga subjekti i rivlerësimit për të përfituar kredinë e marrë nga “Raiffeisen Bank”.

Në lidhje me këtë fakt subjektit i rivlerësimit sqaron se: *“Në kushtet e përfitimit të kredisë me kushte favorizuese, si gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, nuk më janë kërkuar akte të tjera nga institucionet, sa Ju kërkon, por vetëm kontrata e sipërmarrjes të lidhur midis meje dhe kompanisë së ndërtimit, që në rastin konkret ka qenë kontrata e sipërmarrjes e datës 07.12.2005, mes meje dhe kompanisë “***” sh.p.k., kontratë e cila është revokuar me datë 27.12.2005, dhe nuk kemi asnjë detyrim ndaj njëri tjetrit.*

*Për tërheqjen e kredisë, kam lidhur një kontratë kredie bankare me “Raiffeisen Bank” me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.12.2005, dhe me nënshkrimin e kontratës së hipotekës, po me “Raiffeisen Bank” me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.12.2005, ku unë kam lënë si garanci shtëpinë e prindërve në Shkodër, është bërë e mundur lëvrimi i kredisë me kushte lehtësuese, nga “Raiffeisen Bank.”*

Nga ana e Komisionit është bërë një hetim i thelluar në lidhje me procedurën e dhënies së kësaj kredie nga ku rezulton se:

Nga ana e institucioneve shtetërore, të cilët kanë pasur të drejtë për të dërguar kërkesën e motivuar tek Kryeministri¹, kemi marrë përgjigje negative në lidhje me disponimin nga ana e tyre të kërkesës dhe dokumentacion të dorëzuar nga ana e subjektit të rivlerësimit për të përfituar këtë kredi.

Në lidhje me pagesat e interesit në shumën 9% “Raiffeisen Bank” na ka vënë në dispozicion dosjen e aplikimit të dorëzuar pranë saj si dhe na informon se kjo kredi paguhet rregullisht nga ana e Ministrisë së Financave dhe subjektit përkatësisht sipas përqindjeve.

Fakti i pagesës së kredisë nga ana e Ministrisë së Financave nuk provohet nga dokumentacioni i administruar nga ana e Komisionit, pasi Ministria e Financave kërkesën tonë nëpërmjet së cilës kërkonim informacion të detajuar për pagesat e interesit të kredisë të marrë nga ana e subjektit të rivlerësimit ia ka deleguar Entit Kombëtar të Banesave, i cili na informon se ai nuk ka përfituar banesë apo kredi nga programet e strehimit që aplikon Enti.

¹Bazuar në pikën 5 të VKM-së nr. 102, datë 05.03.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore” ku parashikohet se: “Listat për marrjen e kredive nga funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhen me miratimin e Kryeministrit, pas kërkesës së motivuar të ministrive dhe të institucioneve përkatëse. Listat për marrjen e kredive, sipas paragrafit të mësipërm, dërgohen në “Raiffeisen Bank” nga Kryeministri. Banka respekton emrat dhe radhën e vendosur në këto lista nga Kryeministri.”

Duke qenë se nga ana e subjektit të rivlerësimit deklarohet se nuk është kryer asnjë pagesë për llogari të shoqërisë së ndërtimit “***” sh.p.k., duket sikur kjo kontratë sipërmarrjeje midis tyre është lidhur në mënyrë fiktive vetëm për qëllimin e përfitimit të kredisë me kushtet lehtësuese. Në lidhje me këtë dyshim të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës.

Në shpjegimet e tij, subjekti rikonfirmon sqarimet e tij, të paraqitura edhe më parë, duke sqaruar se kishte negociuar me shoqërinë “***”, duke nënshkruar kontratën e sipërmarrjes, dhe ndërkohë që me këtë shoqëri nuk kishte kryer asnjë transaksion financiar, por vetëm kishte aplikuar për kredi, kishte ardhur në dijeni të ofertës së shoqërisë “***” sh.p.k., ofertë kjo që e kishte marrë në konsideratë për shkak të çmimit okazion, të vendndodhjes së pallatit, si dhe kohës më të shpejtë të përfundimit të ndërtimit.

Nga deklaratimet e subjektit, si dhe dokumentacioni i dërguar nga shoqëria “***”, konstatohet se palët nuk kanë bërë pagesa ndërmjet tyre. Referuar VKM-së nr. 102, datë 05.03.1999, "Për trajtimin me strehim të të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore", i ndryshuar, si dhe marrëveshjes së nënshkruar nga Ministria e Financave dhe “Raiffeisen Bank”, më datë 20.06.2005, një nga dokumentat e nevojshëm për aplikim për blerjen e apartamentit në ndërtim, është marrëveshja e sipërmarrjes midis aplikantit dhe kompanisë ndërtuese. Subjekti ka depozituar pranë bankës kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “***”, si kusht i domosdoshëm. Kjo kontratë është revokuar më datë 27.12.2005, duke mos sjellë asnjë efekt ndërmjet palëve për shkak të mospagesave të kryera ndërmjet tyre. Më datë 28.12.2005 është tërhequr shuma 4.900.000 lekë nga ana e subjektit të rivlerësimit pranë “Raiffeissen Bank” dhe më datë 29.12.2005 subjekti ka nënshkruar kontratën me shoqërinë e ndërtimit “***”, duke kryer edhe pagesën sipas parashikimit të kontratës.

Pavarësisht shpjegimeve të subjektit, mbetet fakt se në dosjen e kredisë së lëvruar nga “Raiffeissen Bank” gjendet e depozituar kontrata e lidhur me “***”. Subjekti pretendoi në seancë për neglizhencë të tij në njoftimin e kësaj banke për ndryshimin e kontratës së sipërmarrjes.

Nisur nga të gjitha provat e administruara, Komisioni vlerëson se nuk jemi në kushtet e mashtrimit në kredi, për aq kohë sa nuk gjendet asnjë indicie që të çojë në qëllimin për të mos e kthyer kredinë e marrë. Kredia është përdorur për të njëjtin qëllim për të cilin është lëvruar, për blerjen e apartamentit/ banesës, nga i njëjti kredimarrës, ashtu siç është edhe qëllimi i dhënies së kredisë. Mosnjoftimi i bankës për ndryshimin e kontratës së sipërmarrjes nuk mund të përbëjë shkak të arsyeshem për prishjen e kontratës së kredisë me kushte lehtësuese dhe as për lindjen e dyshimeve për veprime të paligjshme, për aq kohë sa subjekti është korrekt në shlyerjen e detyrimeve, fakt ky i pranuar nga banka kredidhënëse. Kjo kredi është përdorur për të njëjtin qëllim që është lëvruar, financimin e blerjes së një apartamenti. Nga ana tjetër, ky arsyetim mbështetet edhe nga fakti se kjo kredi është siguruar nga një pasuri tjetër, e ndryshme nga pasuria për të cilën është dhënë kredia. Konkretisht, kjo kredi bankare është siguruar nëpërmjet hipotekimit të shtëpisë së prindërve të subjektit në Shkodër, pasuria nr. ***, truall + ndërtesë 900 m², duke garantuar kthimin e saj.

Në këto kushte, Komisioni çmon se subjekti ka qenë i pakujdesshem në rifreskimin e dokumentacionit të kredisë, por kjo pakujdesi nuk vlerësohet të ketë sjellë pasoja negative për bankën kredidhënëse dhe as të krijojë dyshime se është bërë me qëllim kryerjen e veprimeve të paligjshme nga ana e subjektit.

Përveç kredisë, si burim për blerjen e apartamentit, subjekti ka deklaruar edhe kursime familjare. Bazuar në deklaratën periodike të interesave private të vitit 2005 të subjektit të rivlerësimit është deklaruar dhe shuma 10.000 euro si e ardhur e siguruar nga ana e të fejuarës të tij (aktualisht bashkëshortja) E.H. Në lidhje me aftësinë financiare të znj. E. H referojuni analizës financiare të kryer në pikën 4 më poshtë.

Në përfundim të kësaj analize, vërehet se:

- ✓ Përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara;
- ✓ Subjekti ka pasur mundësi financiare për këtë pasuri të paluajtshme.

2. Autoveturë tip Mercedes Benz me targë ***, fituar me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.01.2011, në vlerën 1.000.000 lekë.

Burimi i krijimit sipas “Deklaratës së Pasurisë, Vetting”:

*Të ardhura nga paga në vite e subjektit dhe e bashkëshortes dhe të ardhura nga shitja e automjetit të mëparshëm tip Mercedes Benz, me vlerë 250.000 lekë, shitur me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.07.2009.*

Për këtë pasuri, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Kontratë shitblerjeje pasurie të luajtshme automjet, autoveturë Mercedes Benz, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.07.2009.
- Vërtetim nr. ***prot., datë 14.10.2016, i Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor Tiranë.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot., datë 21.12.2017, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Me shkresë nr. *** prot., datë 27.12.2017, DPSHTRR na informon: *Subjekti i rivlerësimit ka në pronësi mjetin me targa ***.*

Me shkresë nr. *** prot., datë 15.01.2018, DPSHTRR na vë në dispozicion dosjen e mjetit.

Arsyetimi ligjor:

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se subjekti i rivlerësimit ka blerë mjetin tip Mercedes Benz me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.01.2011, në vlerën 1.000.000 lekë.

A. Për blerjen e këtij mjeti, subjekti deklaron të ketë përdorur si burim, të ardhurat nga shitja e mjetit të mëparshëm. Subjekti i rivlerësimit, më datë 19.10.2007, ka blerë mjetin tip Mercedes

Benz me vlerë 200.000 lekë, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol. Nga verifikimi i dokumentave doganore të këtij mjete rezulton se ai është blerë nga shitësi në vlerën 3.255 euro (kurs këmbimi 123.08 lekë) ose 400.365 lekë, nëse çmimi i shtojmë dhe vlerën e doganës prej 287.974 lekë kemi një vlerë totale prej 688.339 lekë. Referuar llogaritjes së mësipërme, si dhe kontratës së shitblerjes rezulton se makina tip Mercedes Benz është blerë nga ana e subjektit të rivlerësimit me një vlerë më të ulët se kosto reale e blerjes së saj.

Në deklaratën e interesave private periodike të vitit 2007 subjekti e ka deklaruar vlerën e blerjes së kësaj makine në shumën 600,000 lekë.

Në lidhje me këtë konstatim subjektit të rivlerësimit iu kërkua informacion shtesë. Në përgjigjen e tij ai sqaron se: *“Çmimi prej 600.000 lekësh që ka deklaruar në ILDKPI-ja në vitin 2007 është vlera reale e këtij mjete që unë kam paguar. Vendosja e çmimit në kontratë më të ulët është ose lapsus ose tendencë e shitësit për të deklaruar çmim më të ulët, me qëllim që ai t'i shmangej taksave.”*

B. Ky mjet është shitur nga ana e subjektit të rivlerësimit për shumën 250.000 lekë, më datë 20.07.2009, me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol.

Ndërkohë subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të interesave private të vitit 2009 deklaroi shitje makine për shumën 700.000 lekë.

Ky deklarim i subjektit nuk përputhet dhe me deklarin e tij në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting” ku ka deklaruar si burim për blerjen e makinës të ardhura nga shitja e automjetit të mëparshëm tip Mercedes Benz vlerën 250.000 lekë.

Në lidhje me këto gjetje, subjektit iu kalua barra e provës për:

- ⊗ Mospërputhje midis çmimit të blerjes në kontratën e shitblerjes sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.10.2007, dhe çmimit të blerjes të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave private të vitit 2007.
- ⊗ Mospërputhje midis çmimit të shitjes të përcaktuar në kontratën e shitblerjes së mjetit tip Mercedes Benz nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.07.2009, me çmimin e deklaruar në deklaratën e interesave private të vitit 2009.

Në shpjegimet përfundimtare të tij, subjekti shprehet se nuk ka prova të tjera në lidhje me shitblerjen e autorveturës tip Mercedes Benz, por i konsideron pasaktësitë e evidentuara si neglizhencë, pa qëllim fshehje të pasurisë apo përfitime të paligjshme nga persona të tretë.

Duke shqyrtuar dokumentacionin, Komisioni arsyeton se, pavarësisht se çmimi i mjetit në kontratë është më i ulët se vlera me të cilën mjete është blerë nga shitësi, duhet pasur parasysh që në përfundim pagesa është bërë jo vetëm për vlerën e mjetit, por edhe për detyrimet doganore që janë paguar për të, të cilat në llogaritjen tonë bazuar mbi dokumentat doganore shkojnë me përafërsi në shumën që subjekti ka deklaruar.

Në lidhje me pasaktësinë në deklaratën e vitit 2007 dhe 2009, në lidhje me vlerën përkatësisht të blerjes dhe shitjes së këtij automjeti, konstatohet se këto dy deklarime nuk përputhen me vlerën e

transaksioneve, siç parashikohen në kontratat përkatëse, por subjekti ka qenë i saktë në deklarinimin e këtij veprimi financiar në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting”.

Komisioni arsyeton se pika 2 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar detyrimin e subjektit të dorëzohet/plotësojë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë. Sipas Kushtetutës, dokumenti ligjor, prej ku fillon të evidentohen përgjegjësitë e subjektit për shkelje disiplinore është pikërisht kjo deklaratë dhe të dhënat që ajo përmban. Kushtetuta e ka lidhur drejtpërdrejt përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit me Deklaratën e Re të Pasurisë, dhe jo me deklarinimet e mëparshme të tij. Këto deklarime, mund të shërbejnë si provë për Komisionin në proces, por nuk mund të jenë shkak për shkarkimin e subjektit. Konkluzioni përfundimtar i Komisionit do të duhet të nxirret nga motivi dhe sjelljet e subjektit, nga mënyra e plotësimit të deklaratës vetting dhe nga të dhënat e hedhura në të. Përdorimi i deklarimeve në vite shërben për të analizuar vlerën e kësaj prove në raport me provat e tjera, me qëllim përcaktimin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë. Duke analizuar pasaktësitë e konstatuara, Komisioni konkludon se subjekti nuk ka pasur qëllim të fshehtë pasuri apo të ardhura. Pavarësisht kësaj, subjekti është treguar neglizhent dhe i pakujdesshëm në nënshkrimin e kontratës së shitblerjes në vitin 2007, duke i krijuar mundësinë blerësit për evazion fiskal. E njëjta gjë konstatohet edhe në deklarinimin e kryer nga subjekti në vitin 2009. Por duke pasur parasysh saktësinë e deklarinimit në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting”, që është detyrim kushtetues, bazuar edhe në parimin e proporcionalitetit, Komisioni vlerëson se këto pasaktësi nuk mund të çojnë në marrjen e masës së shkarkimit të subjektit nga detyra.

3. Depozitë në “BKT” në vlerën 40.324,27 euro hapur në 09.12.2014, si dhe depozitë e lirë me gjendje 1.400 euro.

Burimi i deklaruar i krijimit sipas “Deklaratës së Pasurisë, Vetting”:

*Kursimet familjare dhe 30.000 euro dhuratë nga babai vërtetuar me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.12.2012.*

Në lidhje me këtë depozitë kursimi, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Deklaratë noteriale, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.12.2012;
- Kontratë depozite bankare, datë 09.12.2014;
- Kontratë depozite bankare, datë 23.03.2016;
- Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 25.11.2014, i Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- Aktmarrëveshje (deklaratë noteriale) nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 03.09.2012;
- Vërtetim nr. *** prot., datë 13.01.2017, nga “BKT”.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot., datë 21.12.2017, drejtuar 27 bankave dhe institucioneve të tjera financiare.

Me shkresë nr. *** prot., datë 05.01.2018, “BKT” na informon se:

Z. Dritan Hallunaj ka depozitë në euro me vlerë 40.000 euro.

- Shkresë nr. *** prot., datë 21.12.2017, drejtuar ZQRPP-ve.

Me shkresë nr. *** prot., datë 27.12.2017, ZQRPP ia delegon ZVRPP Shkodër.

Me shkresë nr. ***, ZVRPP Shkodër na vë në dispozicion të dhënave mbi pasurinë e regjistruar në emër të personit juridik “***” sh.p.k., por nuk shpjegon kufizimet e kësaj prone dhe situatën aktuale sot.

Me shkresë nr. *** prot., datë 10.02.2018, ZVRPP Shkodër plotëson të dhënave.

- Shkresë nr. ***, datë 21.12.2017, drejtuar ZVRPP Shkodër.

Me shkresë nr. *** prot., datë 05.01.2018, ZVRPP Shkodër: *Na informon mbi pasuritë e paluajtshme në pronësi të personave të lidhur të subjektit pasi ai nuk ka prona të regjistruar në emër të tij por nuk na jep dosjet e plota të këtyre pasurive për të kuptuar ndryshimet e ndodhura dhe formën e përfitimit.*

Me shkresë nr. *** prot., datë 26.01.2018, ZVRPP Shkodër: *Na informon mbi pasurinë e paluajtshme të z. F.H me sipërfaqe 900 m² nga ku nuk rezulton e shitur asnjë pjesë e saj.*

- Shkresë nr. *** prot., datë 12.06.2018, drejtuar Agjencisë së Trajtimit të Pronave.

Me shkresë nr. *** prot., datë 20.06.2018, Agjencia e Trajtimit të Pronave na vë në dispozicion informacionin e kërkuar, i cili ishte administruar edhe më parë nëpërmjet ZVRPP Shkodër.

Arsyetimi ligjor:

A. Për të vlerësuar shumën prej 30.000 eurosh, që subjekti ka përfutur me anë të dhurimit nga babai i tij dhe që më pas e ka përdorur si burim kryesor krijimi të depozitës pranë “BKT”, Komisioni u përqëndrua në dy momente, së pari në ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave, dhe së dyti, në ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Për të kuptuar burimin e krijimit të kësaj depozite të subjektit të rivlerësimit, Komisioni kreu hetim në lidhje me aktmarrëveshjen (deklaratë noteriale), nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 03.09.2012, nëpërmjet së cilës z. F.H ka hequr dorë nga pjesa e tij takuese mbi sipërfaqen prej 109 m² dhe në kompensim ka marrë në dorë nga shtetasi K.Gj shumën prej 30.000 euro.

Kjo aktmarrëveshje referuar shkresës nr. *** prot., të ZVRPP Shkodër nuk rezulton e regjistruar si dhe referuar të dhënave të administruara nga kjo zyrë nuk rezulton që z. F. H të jetë pronar i ndonjë pasurie me sipërfaqe 109 m².

Në lidhje me këtë pikë subjektit të rivlerësimit iu kërkua informacion shtesë. Ai sqaron se xhaxhallarët e tij shtetasi V dhe F. H për pjesën e tyre takuese të sipërfaqes së truallit, kanë bërë një marrëveshje me subjektin “***” sh.p.k., me pronar z. K.Gj, për ndërtimin e një “Ndërtese banimi 8 kat + 2 kat dyqane + bodrum”. Subjekti “***” sh.p.k., me pronar z. K.Gj, është pajisur me lejen e ndërtimit të dhënë nga Bashkia Shkodër me nr. ***, datë 20.09.2006, për ndërtimin e

pallatit në sipërfaqen e përbashkët prej 2032 m². Sipas akteve ka rezultuar se pjesa e bashkëpronësisë së xhaxhallarëve të tij shtetasve V dhe F.H rezulton të jetë 1923 m².

Përsa më sipër, për ZVRPP Shkodër ka rezultuar se për sipërfaqen prej 109 m² mungojnë marrëdhëniet me pronarët e truallit, dhe për këtë arsye ky institucion ka urdhëruar që të vendoset kufizimi i veprimeve për rregjistrimin e apartamenteve, njësave, bodrumit dhe ambienteve të tjera të ndërtuara nga subjekti “***” sh.p.k. Lidhur me këtë sipërfaqe prej 109 m², babai i tij, z. F.H dhe shoqëria e ndërtimit “***” sh.p.k., me pronar z. K.Gj, kanë bërë një Aktmarrëveshje me deklaratën noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 03.09.2012, sipas së cilës babai i subjektit ka hequr dorë nga pjesa e tij takuese mbi sipërfaqen prej 109 m² dhe në kompensim ka marrë në dorë nga shtetasi K.Gj shumën prej 30.000 eurosh. Pas këtij veprimi ZQRPP-ja, me shkresën nr. ***prot., datë 14.09.2012, ka urdhëruar ZVRPP Shkodër që të vijojë procedurat e rregjistrimit të pasurive të mësipërme pasi është arritur marrëveshja.

Në lidhje me këtë deklaram nga dokumentacioni i administruar nga ana e ZVRPP Shkodër rezulton se:

Më datë 25.07.2011, me urdhër nr. *** të Regjistruarit të ZVRPP-së Shkodër është vendosur kufizimi i veprimeve për pasurinë me nr. *** ZK. *** regjistruar në nr. *** hipotekor, datë 16.06.2011, vol. *** faqe *** si dhe pasuritë e pallatit të regjistruara në nr. ***hipotekore, datë 16.06.2011, vol. *** faqe ***. Ky kufizim është vendosur deri në përfundimin e relacionit përfundimtar dhe dërgimin e qëndrimit të ZQRPP-së në lidhje me këtë regjistrim.

Ky urdhër i është njoftuar firmës së ndërtimit “***” sh.p.k., dhe z. F.H e z. V.H, me shkresë nr. ***prot., datë 26.07.2011.

Në datë 17.11.2011, me urdhër nr. *** të Regjistruarit të ZVRPP-së Shkodër, është vendosur heqja e kufizimit të veprimeve me pasurinë nr. *** ZK *** regjistruar në nr. *** hipotekor, datë 16.06.2011.

Në lidhje me këtë konstatim, subjektit të rivlerësimit iu kërkua informacion më i detajuar. Në përgjigjen e tij ai sqaron se babait të tij, shtetasit F.H, së bashku me trashëgimtarët e tjerë të të ndjerit S.H, i është kthyer në pronësi një sipërfaqe trualli prej 4120 m², për të cilën është bërë akti i pjesëtimit ku është ndarë, sipërfaqja e tokës prej 3050 m² dhe ka ngelur në bashkëpronësi të z. F.H, z. V.H dhe z. F.H (pasi znj. B.H dhe znj. N.H kanë hequr dorë me aktin nr. ***, datë 05.12.1996) sipërfaqja prej 1070 m². Xhaxhallarët e tij shtetasit V dhe F.H, për pjesën e tyre takuese të sipërfaqes së truallit, kanë bërë një marrëveshje me subjektin “***” sh.p.k., me pronar z. K.Gj, për ndërtimin e një “Ndërtese banimi 8 kat + 2 kat dyqane + bodrum”. Sipas akteve ka rezultuar se pjesa e bashkëpronësisë së xhaxhallarëve të tij shtetasve V dhe F.H (dhe N.H), rezulton të jetë 1923 m² (750 + 600 + 600). Pikërisht, meqenëse sipërfaqja e truallit ishte 1923 m², ndërsa leja për ndërtimin e pallatit në sipërfaqen e përbashkët ishte 2032 m², duke rezultuar diferenca prej 109 m², e cila është pjesë e pjesës së përbashkët prej 1070 m², që kishte ngelur në bashkëpronësi të z. F.H, z. V.H dhe z. F.H. Meqenëse marrëdhëniet me shtetasit V.H e F. H dhe shoqërisë së ndërtimit “***” sh.p.k., ishin vendosur më parë, babai i subjektit ra dakord dhe nënshkroi deklaratën noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.09.2012, sipas së cilës heq dorë nga pjesa e tij takuese mbi sipërfaqen prej 109 m², duke ia lënë kështu në bashkëpronësi dy vëllezërve të tij, z. V dhe z. F.H, dhe në kompensim ka marrë nga shtetasi K.Gj shumën prej 30.000 (tridhjetëmijë) eurosh. Vetëm pasi është sqaruar e zgjidhur si më sipër marrëdhënia me

pronarët e truallit, ZQRPP-ja me shkresën nr. ***, datë 14.09.2012, ka urdhëruar ZVRPP Shkodër, që të vijojë procedurat e regjistrimit të pasurive të mësipërme. Në përmbajtje të kësaj shkrese, ndër të tjera sqarohet se heqja e kufizimit urdhërohet: “.....si rezultat i aktmarrëveshjes së kryer me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 03.09.2012, midis z. F.H dhe z. K.Gj.”

Këto shpjegime subjekti i ka shoqëruar edhe me dokumentacion provues, i njehsuar nga ZQRPP, duke vërtetuar se sipërfaqja 109 m² ka qenë pjesë e pronës të papjesëtuar nga ana e babait dhe xhaxhallarëve të tij me sipërfaqe totale 1070 m² dhe se babai i tij, duke qenë i vetmi që nuk kishte marrëdhënie me “***” sh.p.k., ka hequr dorë nga pjesa e tij takuese dhe vetëm pas arritjes së kësaj marrëveshje nga ana e ZVRPP Shkodër është hequr kufizimi.

Nga analiza e dokumentacionit rezulton se:

- Në datë 21.07.2011, me shkresë nr. ***prot., ZQRPP-ja i ka kërkuar ZVRPP Shkodër që të vendos kufizimin e veprimeve për pasurinë nr. *** ZK. ***.
- Në datë 25.07.2011, është nxjerrë Urdhëri i kufizimit nr. ***, i ZVRPP Shkodër, ku është vendosur kufizimi i veprimeve për pasurisë nr. ***ZK. ***.
- Në datë 26.07.2011, me shkresë nr. ***prot., ZVRPP Shkodër ka njoftuar z. F.H, z. V.H dhe “***” sh.p.k.
- Në datë 05.04.2012, me shkresë nr. *** prot., Ministria e Drejtësisë i kërkon ZQRPP dhe ZVRPP Shkodër të trajtojë ankesën e z. K.Gj.
- Në datë 19.04.2012, me shkresë nr. *** prot., ZVRPP Shkodër informon ZQRPP se pasuritë e regjistruara në ZK *** me nr. hipotekor ***, datë 16.06.2011, vazhdojnë të jenë të kufizuara.
- Në datë 07.05.2012, me shkresë nr. *** prot., është hartuar një relacion në lidhje me kufizimin e kryer nga ana e ZVRPP Shkodër për pasurinë nr. *** në pronësi të “***” sh.p.k., nga ku rezulton se ky kufizim nuk është hequr ende.
- Në datë 18.07.2012, me shkresë nr. *** prot., ZQRPP-ja informon “***” sh.p.k., se pasuritë do të rrinë të kufizuara deri në krijimin e marrëdhënieve me pronarët e truallit
- Në datë 03.09.2012 është lidhur aktmarrëveshja (deklarata noteriale) nr. *** midis “***” sh.p.k. dhe z. F.H.
- Në datë 14.09.2012, me shkresë nr. *** prot., ZQRPP-ja i kërkon ZVRPP Shkodër të marrë në trajtimin ankesën e subjektit “***” sh.p.k. si dhe nga ana e subjektit të bëhet aplikimi pranë kësaj zyre.

Me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.12.2012, vërtetohet dhurimi i kësaj shume prej 30.000 eurosh nga babai te subjekti i rivlerësimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se z. F.H nuk ka paguar detyrimet tatimore për shumën prej 30.000 eurosh që ka përfituar, gjë që e ka konfirmuar edhe vetë subjekti në shpjegimet e tij.

Duke qenë se në dokumentacionin e përcjellë nga ZVRPP Shkodër, nuk pasqyrohet regjistrimi i aktit të heqjes dorë të z. F.H nga sipërfaqja prej 109 m², si dhe nuk rezultoi tatim i paguar për shumën prej 30.000 eurosh, subjektit iu kalua barra e provës.

Në shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit rikonfirmoi qëndrimin e mbajtur edhe më parë në përgjigje të pyetësorëve nga ana e Komisionit, si dhe depozitoi edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Shkresë e ZQRPP me nr. ***prot., datë 21.07.2012.
2. Kthim përgjigje nga ana e ZQRPP-ve, me shkresën nr. ***, datë 18.07.2012.
3. Shkresë e Zyrës Qendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme Tiranë me nr. *** prot., datë 14.09.2012.

Ndërsa në seancën dëgjimore subjekti i rivlerësimit dorëzoi dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Mandat datë 30.07.2018, këmbim valutë *cash* i “Raiffeisen Bank” për shumën 3.400 euro nënshkruar nga E. Ll.
2. Mandat datë 30.07.2018, derdhje për segmentin e taksave për pagimin e tatimit mbi të ardhurat individuale janar - dhjetor 2012 në shumën 416.879 lekë nënshkruar nga E. Ll.
3. Urdhërpaguesë për tatimin mbi të ardhurat individuale për z. F.H në shumën 416.670 lekë.
4. Deklaratë Individuale Vjetore e të Ardhurave e z. F.H për vitin 2012 deklaruar në datë 30.07.2018.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se aktmarrëveshja (deklarata noteriale) nr. ***midis “***” sh.p.k., dhe z. F.H gjendet e depozituar pranë ZQRPP-së, për pasojë kjo zyrë i ka urdhëruar ZVRPP Shkodër të marrë në trajtimin ankesën e subjektit “***” sh.p.k., heqjen e kufizimit mbi ndërtimin e kryer nga kjo shoqëri, si dhe njoftimin e subjektit për kryerjen e aplikimit pranë ZVRPP Shkodër.

Bazuar në nenin 32/1 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë detyrimin të justifikojë ligjshmërinë e burimit të pasurisë. Nga analiza e fakteve të mësipërme rezulton se personi tjetër i lidhur me subjektin, z. F.H, ka justifikuar me dokumentacion provues ligjshmërinë e burimit të pasurisë.

Duke qenë se nga heqja dorë e të drejtës së pronësisë mbi këtë pasuri, personi tjetër i lidhur ka përfituar të ardhura, që më pas ia ka dhuruar subjektit, Komisioni vlerësoi edhe faktin nëse për këto të ardhura është paguar tatimi, siç parashikohet në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Nga provat e depozituara nga subjekti në seancën dëgjimore, rezulton se për shumën e përfituar nga z. F.H është paguar tatimi mbi të ardhurat personale në datën 30.07.2018, z. F.H, në cilësinë e individit, kishte detyrimin të paguante tatimin mbi të ardhurat personale në kuptim të pikës “dh” të nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Neni 13/9 i po këtij ligji përcakton se për mosplotësim në kohë të deklaratës vjetore të të ardhurave, zbatohen sanksionet administrative, të përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore. Neni 113 i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se të gjithë tatimpaguesit, përveç tatimpaguesit të tatimit mbi fitimin, që nuk dorëzojnë në afatin e përcaktuar sipas ligjit përkatës deklaratën tatimore, për të cilën detyrohen sipas ligjit të deklarohen, dënohen me 5.000 lekë gjobë për çdo deklaratë tatimore të padorëzuar në afat. Pra ligji tatimor nuk e pengon tatimpaguesin të shlyejë detyrimet tatimore edhe me vonesë, për këtë ai është i detyruar të paguajë gjobën përkatëse, që llogaritet nga organi tatimor.

Në vlerësimin e kësaj prove, Komisioni ka mbajtur parasysh se dispozitat e legjislacionit financiar nuk pengojnë pagimin e tatimit, përtej afatit të parashikuar, si dhe faktin që subjekt i detyrimit tatimor ka qenë babai i subjektit dhe jo vetë subjekti. Nëpërmjet pagimit të tatimit është përmbushur detyrimi ndaj buxhetit të shtetit duke u ligjësuar kështu burimi i këtyre të ardhurave në favor të subjektit.

Si burim për krijimin e depozitës bankare, subjekti ka deklaruar, përveç shumës prej 30.000 eurosh të dhuruara nga babai i tij, edhe kursimet familjare ndër vite, për të cilat, bazuar në deklaratat periodike vjetore të subjektit, rezulton se deri në fillim të vitit 2013 ai ka patur kursime *cash* nga paga e tij dhe e bashkëshortes në vlerën 900.000 lekë, të cilat i ka përdorur për çeljes e depozitës prej 40.000 eurosh në vitin 2014 në Bankën Kombëtare Tregtare.

4. Në deklaratën e pasurisë të vitit 2006, subjekti ka deklaruar se nga ana e bashkëshortes është kontribuar me të ardhurat në shumën 3.000.000 lekë të dhururara nga babai i saj, z. B.LI, me rastin e martesës (prikë). Një pjesë e këtyre të ardhurave janë konsideruar nga subjekti si kursime familjare të përdorura për blerjen e apartamentit.

Me qëllim vërtetimit të saktësisë së këtij deklarimi, Komisioni ka kryer këtë hetim:

- Shkresë nr. *** prot., datë 21.12.2017, drejtuar 27 bankave dhe institucioneve të tjera financiare.

Banka e Shqipërisë me shkresë nr. *** prot., datë 26.12.2017, informon se z. B.LI ka blerë bono privatizimi.

Fibank me shkresë nr. *** prot., datë 26.12.2017, na informon se z. B.LI dhe znj. A.LI kanë llogari bankare pranë kësaj banke.

Me shkresë nr. *** prot., datë 05.01.2018, “BKT” na informon se z. B.LI dhe znj. A.LI kanë llogari bankare pranë kësaj banke.

“Credins Bank” me shkresë nr. *** prot., datë 16.01.2018, informon se z. B.LI, dhe znj. A.LI kanë llogari bankare pranë kësaj banke.

- Shkresë nr. *** , datë 21.12.2017, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve .

Me shkresë nr. *** prot., datë 28.12.2017, Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve informon se vetëm shtetasi B.LI figuron me aktivitet me NIPT ***.

DPT me shkresë nr. *** prot., datë 29.12.2017, i kërkon informacion Drejtorisë Rajonale Shkodër për subjektin B.LI.

Me shkresë nr. *** , datë 10.1.2018, Drejtorja Rajonale Tatimore Shkodër informon se:

*Pas verifikimit në sistemin tatimor C@ts u konstatua se subjekti B.LI me NIPT *** rezulton i regjistruar që më datë 16.03.2006.*

- Shkresë nr. *** prot., datë 17.01.2018, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër.

Me shkresë nr. *** prot., datë 25.01.2018, DRT Shkodër na vë në dispozicion informacionin e kërkuar.

- Shkresë nr. *** prot., datë 21.12.2017, drejtuar QKB-së.

Me shkresë nr. *** prot., datë 11.01.2018, të QKB-së rezulton se z. B.LI është i regjistruar pranë QKB-së dhe ka licencë aktive për “***”.

- Pasi janë analizuar përgjigjet e ardhura nga bankat e ndryshme i është dërguar shkresë nr. ***, datë 09.01.2018, Drejtorisë së Arkivit Qëndror të ISSH dhe shkresë nr. *** prot., datë 09.01.2018, ISSH-së.

Më datë 15.01.2018, me shkresë nr. ***, ISSH-ja, na ka vënë në dispozicion informacion mbi të dhënat e punësimit.

- Shkresë nr. *** drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër.

Me shkresë nr. ***, datë 31.1.2018, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër na vë në dispozicion informacionin e kërkuar.

- Shkresë nr. *** prot., datë 07.02.2018, drejtuar noterit publik, znj. B. N.

Me shkresë nr. s'ka, datë 23.02.2018, noteri publik na vë në dispozicion informacionin e kërkuar.

- Shkresë nr. *** prot., datë 07.02.2018, drejtuar noterit publik, z. A. K.

Me shkresë nr. ***, datë 22.02.2018, noteri publik na vë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar.

- Shkresë nr. ***, datë 21.12.2017, drejtuar ZVRPP Shkodër.

Me shkresë nr. *** prot., datë 22.02.2018, ZVRPP Shkodër na vë në dispozicion informacionin e kërkuar.

- Shkresë nr. *** prot., datë 21.02.2018, drejtuar ALUZINI Shkodër.

Me shkresë nr. *** prot., datë 01.03.2018, ALUIZNI Shkodër na vë në dispozicion informacionin e kërkuar.

Arsyetimi ligjor

Në “Deklaratën - Vetting”, si burim për blerjen e apartamentit janë deklaruar përveç kredisë, edhe kursime familjare, të cilat deri në momentin e blerjes, pra brenda vitit kur familja sapo është krijuar nuk mund të ishin gjë tjetër veçse prika e sjellë nga bashkëshortja e subjektit.

Subjekti i rivlerësimit në asnjë nga deklaratat e mëvonshme periodike nuk deklaroi se për çfarë u përdor kjo shumë apo si u shpenzua. Në lidhje me këtë konstatim atij iu kërkua informacion shtesë. Subjekti i rivlerësimit në përgjigjen e tij sqaroi se:

- 9.000 euro janë përdorur në vitin 2005 për blerjen e apartamentit;
- 720.000 lekë janë përdorur për arredimin e shtëpisë;

- Ndërsa shuma tjetër prej 1.200.000 lekësh është përdorur për nevoja familjare.

Për të vërtetuar aftësinë paguese të z. B.Ll për t'i dhënë vajzës së tij si prikë shumën 3.000.000 lekësh, në vitin 2006, nga ana e Komisionit u krye një hetim i plotë i pasurisë së tij nga ku rezultoi se:

- Bazuar në të dhënat e siguruar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër rezulton se z. B.Ll, me NIPT *******, është i regjistruar që më datë 16.03.2006 dhe se ka raportuar qarkullimin dhe fitim sipas periudhave:

Viti	Qarkullimi	Fitimi
2006	1.500.000	Nuk ka informacion
2007	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion
2008	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion
2009	1.890.000	425.000
2010	1.800.000	111.412
2011	1.186.438	177.966
2012	1.485.783	583.000
2013	0	0
2014	2.029.962	129.962
2015	1.827.200	1.266.218
2016	3.243.500	2.440.442

Siç konstatohet nga përgjigja e Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me aktivitetin apo të ardhurat e z. B.Ll për vitin 2005 apo më parë.

- Bazuar në të dhënat e administruara nga ana e bankave në tabelën e mëposhtme janë të pasqyruara gjendjet në llogaritë bankare të familjes Ll:

VITET	DERDHJE			INTERESA			TOTAL		
	LEKË	USD	EURO	LEKË	USD	EURO	LEKË	USD	EURO
2002	1.099.640		74.230				11.209.815		
2003	1.900.000			1.003.963			14.113.778		
2004	2.600.000			965.160			17.678.938		
2005	1.800.000			798.908			20.277.846		
2006	1.800.000	20.000					22.077.846	20.000	
2007				1.173.293			23.251.139	20.000	

2008							23.251.139	20.000	
2009	-25.589.598			2.338.461			0	20.000	
2010			175.000			2.036	0	20.000	177.036
2011	1.500.000	-1.274	26.000		3.089	5.906	1.500.000	21.815	208.942
2012	477.622			22.383		6.585	2.000.005	21.815	215.527
2013	-9.520		-1	90.492	982	5.003	2.080.977	22.797	220.529
2014	359.176		-1	59.768		7.145	2.499.921	22.797	227.673
2015	5.473.717				650	1.447	7.973.638	23.447	229.120
2016	970.822	-170			169	0	8.944.460	23.446	229.120

Nga analizimi i këtyre llogarive rezulton se që nga viti 2002 e deri në vitin 2016, nga këto llogari nuk janë bërë tërheqje për t'u investuar në pasuri të paluajtshme apo të luajtshme, por këto shuma kanë qarkulluar brenda sistemit bankar.

Në lidhje me burimin e të ardhurave të z. B.Ll dhe znj. A.Ll subjektit të rivlerësimit iu kërkua informacion shtesë. Në përgjigjet e tij ai deklaroi se znj. Ll dhe z. Ll të ardhurat e tyre i kanë siguruar jo vetëm nga ***, por dhe nga aktiviteti tregtar. Për të vërtetuar deklaratimet e tij subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur si prova dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Vërtetimin e Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, që vërteton se ky person ka pasur aktivitetin e tij si mjek stomatolog të rregjistruar me vendim gjykatë që vitin 1994.
2. Kopje të Certifikatës së Rregjistrimit në Organet Tatimore me kod fiskal 3303027, së bashku me dy mandat arkëtime.
3. Vërtetimin e “Bankës Kombëtare Tregtare”, nr. ***, datë 28.10.2016.
4. Vërtetimin e “Bankës së Bashkuar të Shqipërisë” (UBA), nr. ***, datë 31.10.2016.
5. Statment i llogarisë pranë “Bankës Credins”, datë 15.02.2018.
6. Statment i llogarisë pranë “Bankës Kombëtare Tregtare”, datë 27.10.2016.
7. Statment i llogarisë pranë “Bankës Kombëtare Tregtare”, datë 15.02.2018.
8. Kopje të pasaportës së shtetasit B.Ll.
9. Kopje të pasaportës së shtetasit A.Ll.
10. Kthim përgjigje datë 16.02.2018, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër.
11. Vërtetim nr. ***, datë 16.02.2018, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër.
12. Kërkesë për transaksion datë 02.12.2014, pranë “Bankës Kombëtare Tregtare” për transferimin në këtë bankë të fondit ish depozitë, për Bono Thesari.
13. Kartelën e klientit nxjerrë më datë 15.02.2018, për këtë fond.

Nga “BKT” informohemi se më datë 02.09.2002, z. Ll ka pasur depozitë në shumën 74.230.36 euro, si dhe një llogari në lekë në shumën 1.099.640 lekë.

Bazuar në vërtetimin nr. *** prot., datë 31.10.2016, të “Bankës së Bashkuar të Shqipërisë” rezulton se z. Ll ka pasur llogari investuese në shumën 2.500.000 lekë nga data 31.12.2001 - 28.01.2002.

Nga kartela e klientit, z. Ll në “Bankën e Shqipërisë” rezulton se kemi tre transfertat hyrëse nga llogaritë e bankave e nivelit të dytë për blerje bonosh thesari në “Bankën e Shqipërisë”, një më datë 26.11.2015, me vlerë 2.985.678 lekë, e cila është transferuar nga llogaria e znj. A.Ll, në “First Investment Bank”, më datë 04.11.2015, në vlerën 3.000.000 lekë, një më datë 10.12.2015, me vlerë 2.488.032 lekë e cila është transferuar nga llogaria e znj. A.Ll në “Bankën Kombëtare Tregtare”, më datë 02.12.2015, në vlerën 2.500.000 lekë dhe një më datë 22.12.2016, me vlerë 970.791 lekë, e cila është transferuar nga llogaria e z. B.Ll në “First Investment Bank” më datë 22.12.2016, në vlerën 970.791 lekë. Pra në total 6.470.791 lekë.

Bazuar sa më sipër rezulton se z. Ll deri në vitin 2006 ka pasur një pasuri në shumën 17.678.936 lekë.

Nisur edhe nga deklarami i subjektit, z. Ll e ushtron profesionin e stomatologut, që përpara viteve ‘90. Të gjitha kursimet nga puna e tij si stomatolog, si dhe bashkëshortes së tij, ai i ka ruajtur nëpër banka dhe në shtëpi, “sipas mendësisë së tyre dhe periudhës që po kalonte vendi”.

Në analizë të këtyre të dhënave, rezulton se babai i bashkëshortes së subjektit, z. B. Ll, ka pasur mjete monetare të mjaftueshme për t’i dhënë së bijës shumën prej 3.000.000 lekësh në vitin 2006.

Gjatë hetimit administrative, Komisioni konstatoi se z. Ll ka kryer investime në pasuri të luajtshme e të paluajtshme në shumën prej 153.080 euro për periudhën 2004-2015.

Vitet	Investime në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme	
2004	500.000,00 All, blerje automjeti	
2007		12.500,00 euro, blerje automjeti
2010		75.000,00 euro, blerje njësi shërbimi
2012		58.580,00 euro, blerje apartamenti dhe 7.000,00 euro, blerje garazhi
2015	470.000,00 All, blerje pianoje	
Totali	970.000,00 ALL	153.080,00 EURO

Nga ky fakt, Komisionit i lindën dyshime mbi aftësitë investuese të z. Ll në këtë shumë. Për këtë arsye, subjektit të rivlerësimit iu kërkua informacion shtesë për sa i përket blerjeve të këtyre pasurive të paluajtshme të kryera nga ana e vjehrrit të tij. Në kthimin e përgjigjes ai sqaron se në blerjen e këtyre pasurive të paluajtshme nga ana e vjehrrit të tij kanë kontribuar bashkëshortja dhe tri fëmijët e tij, të cilët janë me profesion stomatology, përkatësisht djali dhe dy vajzat e tij, si dhe ekonomiste vajza tjetër. Në përgjigjen e tij subjekti rikonfirmon se as nuk ka pasur dijeni dhe as i ka pasur në përdorim këto prona.

Në lidhje me ndërtimin e kryer në Velipojë nga ana e z. Ll, subjekti sqaron se kjo banesë është ndërtuar atje nga i vjehri në një rrethim së bashku me dy vëllezërit e tij z. B dhe z. B. Ll, si dhe motra e tij e ndjera znj. M. (Ll) H, që në vitin 1997, pra shumë kohë përpara lidhjes së subjektit me bashkëshorten e tij.

Duke qenë se subjekti nuk solli dokumentacion provues për të ardhurat e ligjshme të vjehrrit të tij, në përfundim të hetimit iu kalua barra e provës.

Subjekti i rivlerësimit depozitoi dokumentacionin e mëposhtëm, për të provuar shpjegimet e tij:

1. Vërtetimin e Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, nr. *** prot., datë 04.12.2014.
2. Kopje të Certifikatës së Rregjistrimit në Organet Tatimore me **kod fiskal 3303027** së bashku me këto mandate arkëtime:

- Mandatarkëtim, datë 09.12.1994
- Mandatarkëtim, datë 29.11.1994.
- Fletë njoftim tatimi datë 03.07.1995.
- Mandatarkëtim, datë 09.06.1999, për pagesë e sigurimeve shoqërore për vitin 1995.
- Fletë njoftim tatimi, datë 10.04.1999.
- Mandatarkëtim, datë 12.07.1999.
- Fletë njoftim tatimi, datë 30.01.2001.
- Mandatarkëtim, datë 18.01.2001.
- Mandatarkëtim, datë 05.02.2001.
- Mandatarkëtim, datë 05.03.2002, për tatimin.
- Mandatarkëtim, datë 05.03.2002, për bashkinë, taksë pastrimi etj.
- Mandatarkëtim, datë 02.09.2002.
- Urdhërpagesë, datë 23.03.2003.

Nga analiza e dokumentave të paraqitura nga subjekti rezulton se z. B. Ll është regjistruar pranë organeve tatimore, si biznes i vogël me aktivitetin “***”, që në vitin 1994 dhe ka paguar tatimet në masën 4% për intervalin e xhiros nga 2 - 5 milionë lekë. Për këtë periudhë, ky biznes nuk ka pasur detyrimin për t’u pajisur me kasë fiskale dhe as kryerjen e transaksioneve nëpërmjet sistemit bankar. Në përfundim të shqyrtimit të provave, Komisioni vlerëson se z. Ll ka pasur mundësi financiare për kryerjen e investimeve të përmendura më sipër, duke hequr dyshimet se këto pasuri mund të ishin pasuri të fshehura të subjektit.

5. Nga analiza financiare e kryer mbi të gjitha të ardhurat dhe të gjitha shpenzimet e kryera nga subjekti dhe bashkëshortja e tij (shiko tabelën bashkëlidhur), rezulton se në vitin 2011 ka balancë negative në shumën prej 121.874 lekësh dhe në vitin 2012 ka balancë negative në shumën prej 204 682 lekë duke krijuar dyshime për burime të pamjaftueshme për përballimin e këtyre shpenzimeve.

Përshkrimi	Viti 2011 vlerat në lekë	Viti 2012 vlerat në lekë
Gjendja e likuiditetit në fillim të periudhës	606.002	300.590
Të ardhura nga pagat SR	1.386.091	1.370.669
Të ardhura nga pagat personi i lidhur, bashkëshortja	461.803	486.715
Dhuratë nga babai i subjektit shuma prej 30.000 euro	-	4.191.600
Blerë autoveturë Mercedes Benz në vitin 2011	-1.000.000	-
Shpenzimet për shlyerjen e kredisë	- 291.507	- 284.527
Shpenzimet për arsimimin e fëmijëve	-135.000	- 135.000

Shpenzimet e jetesës dhe shpenzime për kujdesin shëndetësor	- 442.071	- 469.071
Shpenzimet për udhëtime	- 406.602	- 832.800
Gjendja e likuiditetit në fund të periudhës	300.590	4.832.857
Diferenca e pambuluar	-121.874	- 204.682

Për të vërtuar të kundërtën, subjektit iu kalua barra e provës. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se këto diferenca të konstatuara nga ana jonë nuk qëndrojnë, sepse në analizën tonë kemi llogaritur ditë të qëndrimit jashtë shtetit, më shumë nga sa ai ka qëndruar. Në këto kushte, shpenzimet e llogaritura nga jonë janë të gabuara. Për të vërtetuar shpjegimet e tij, subjekti vuri në dispozicion të Komisionit shkresën me nr. *** prot., datë 18.07.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, bashkëlidhur së cilës gjenden disa prej procesverbaleve të seancave gjyqësore, për periudhës kohore 19.12.2011 deri në 30.12.2011, ku subjekti i rivlerësimit, ka qenë prezent, në cilësinë e relatorit/kryesuesit ose anëtarit të trupit gjykues.

Pasi u vlerësuan shpjegimet dhe provat e subjektit, rezulton se në vitin 2011 ka balancë negative në shumën 52.724 lekë dhe në vitin 2012 ka balancë negative në shumën 28.634 lekë.

Përshkrimi	Viti 2011 vlerat në lekë	Viti 2012 vlerat në lekë
Gjendja e likuiditetit në fillim të periudhës	606.002	300.590
Të ardhura nga pagat SR	1.386.091	1.370.669
Të ardhura nga pagat personi i lidhur, bashkëshortja	461.803	486.715
Dhuratë nga babai i subjektit shuma prej 30.000 euro	-	4.191.600
Blerë autoveturë Mercedes Benz në vitin 2011	-1.000.000	-
Shpenzimet për shlyerjen e kredisë	- 291.507	- 284.527
Shpenzimet për arsimimin e fëmijëve	- 135.000	- 135.000
Shpenzimet e jetesës dhe shpenzime për kujdesin shëndetësor	- 442.071	- 469.071
Shpenzimet për udhëtime	- 337.452	- 656.753
Gjendja e likuiditetit në fund të periudhës	300.590	4.832.857
Diferenca e pambuluar	- 52.724	- 28.634

Nisur nga këto vlera të shpenzimeve të pambuluara, Komisioni çmon se masa e tyre është aq e vogël sa mund të konsiderohet edhe si marzh gabimi në përlllogaritjen e shpenzimeve dhe të ardhurave të subjektit e bashkëshortes së tij, kështu që nuk do të merret në konsideratë.

Konkluzion përfundimtar mbi vlerësimin e pasurisë

Subjekti është treguar neglizhent në detyrimin e tij për njoftimin e bankës për revokimin e kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë ndërtuese “***” dhe lidhjen e kontratës së re të sipërmarrjes me shoqërinë ndërtuese “***”. Kjo neglizhencë nuk ka ndikuar në marrëdhënien e subjektit me kredinë në raport me shlyerjen e saj.

Subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë vlerën në blerje dhe shitje të automjetit të tij, përkatësisht në vitet 2007 dhe 2009. Komisioni konstatoi se këto dy deklarime nuk përputhen me vlerën e transaksioneve, siç parashikohen në kontratat përkatëse, por subjekti ka qenë i saktë në deklarimin e këtij veprimi financiar në deklaratën vetting. Në këto kushte vlerësohet se nuk u gjetën prova apo indicie që këto pasaktësi në deklarime janë bërë me qëllim fshehjen e burimit, të ardhurave apo pasurisë.

Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, këto pasaktësi nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se në këtë rast pasaktësitë e konstatuara nuk çmohen se çënojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut tek drejtësia.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe i ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, si dhe nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Hallunaj, nuk vërtetohen shkaqet, që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figures, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 16.01.2018.

Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë është bazuar te:

- Formulari i vetëdeklarimit, të 3 dokumentave ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumentave të tjerë që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për subjektin e rivlerësimit është paraqitur vetëm 1 ankesë në vitin 2015 nga Prokurori i Përgjithshëm për dhënien e vendimit gjyqësor të pafajësisë nr. 73, datë 29.06.2015. Prokurori i Përgjithshëm pretendonte se vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit ishte i paarsyetuar, se zgjidhja e çështjes në themel nga gjykata është e gabuar, se i pandehuri duhej të deklarohej fajtor për akuzat e ngritura, se vlerësimi i provave ishte i gabuar, i njëanshëm dhe në favor të të pandehurit, se ishin refuzuar padrejtësisht disa prova të akuzës. Kjo ankesë është verifikuar nga Inspektorati për mosrespektim formal të ligjit në dhënien e vendimit penal të pafajësisë dhe në përfundim është konstatuar se vendimi gjyqësor i dhënë nga subjekti i rivlerësimit ishte ndryshuar nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, por në vendimin e saj kjo e fundit nuk konfirmonte shkelje të normave urdhëruese procedurale apo mosarsyetim të vendimit gjyqësor. Shkelja e konstatuar nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda lidhet me mënyrën e vlerësimit të provave nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda vetëm për zgjidhjen e çështjes në themel. Rrjedhimisht, u konkludua se ky fakt nuk mbështeste përshtatshëm një procedim disiplinor dhe rrjedhimisht, ky rast i verifikuar iu regjistrua gjyqtarit për efekte të vlerësimit profesional dhe etik.

Nisur nga kjo ankesë, Komisionit i lindën dyshime mbi mundësinë e përfshirjes së subjektit në veprime korruptive. Për këtë arsye iu kërkua organeve informuese/ligjzbatuese informacion për vërtetimin e këtyre dyshimeve. Në përfundim të hetimit në lidhje me këtë çështje Komisioni nuk arriti të krijonte bindjen, madje as të gjente indice, në lidhje me përfshirjen e subjektit në veprime korruptive, duke favorizuar palën në gjykim.

Ky vendim, për të cilin Prokurori i Përgjithshëm ka ushtruar ankim ndaj subjektit në KLD-së, iu nënshtrua vlerësimit edhe nga ana e Komisionit, bazuar në pikën 1 të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016,

i cili referon në burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në këtë vlerësim, Komisioni u kujdes të zbatonte pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, duke mos gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e subjektit të rivlerësimit. Në përfundim Komisioni çmon se subjekti ka treguar aftësi për të interpretuar ligjin, ka argumentuar në mënyrë logjike dhe të strukturuar vendimin, dhe nuk u konstatuan shkelje të normave urdhëruese penale. Në vlerësimin e tij Komisioni mbajti parasysh edhe faktin e përbërjes së trupit gjykues prej pesë anëtarësh.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore për subjektin e rivlerësimit.

Me shkresë nr. *** prot., datë 29.01.2018, KLD-së na informon se për subjektin e rivlerësimit për periudhën janar 2006 deri më sot nga kërkimet e deri më tanishme në zyrën e arkiv/protokolli të KLD-së, disponohen 3 ankesa, një prej të cilave është brenda periudhës së rivlerësimit (shiko më lart) ndërsa për dy të tjerat është konkluduar se nuk është paraqitur asnjë provë për të provuar pretendimin e ankuesit.

Pranë Komisioni janë protokolluar edhe dy denoncime/ankesa, njëra prej tyre anonime.

Nga shqyrtimi i denoncimit të shtetasit A. Z., Komisioni konstatoi se nuk kishte prova apo fakte për të vërtetuar pretendimet e denoncuesit.

Ndërsa nga shqyrtimi i denoncimit anonim, në lidhje me pasuri të fshehura të subjektit, Komisioni iu drejtua organeve ligjzbatuese për verifikimin e vërtetësisë së faktit. Nga këto organe nuk u konfirmua vërtetësia e përmbajtjes së denoncimit.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, nga ana e Komisionit, u bazua në gjetjet e këtij raporti dhe pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet si më poshtë:

a) Lidhur me aftësitë profesionale

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Analizon normën ligjore materiale të zbatueshme në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Subjekti i rivlerësimit ndalet për të identifikuar kërkimet e organit të prokurorisë dhe prapësimet e mbrojtjes, i analizon ato në raport me provat e paraqitura dhe konkludon për faktin penal, si dhe masën e dënimit që duhet caktuar. Përdorimi i referencave në jurisprudencën e mëparshme gjyqësore nuk bëhet rregullisht nëpër vendime apo në dhënien e vendimeve të ndërmjetme, ku është konstatuar vetëm përdorimi i vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese. E njëjta gjë vlen edhe për përdorimin e akteve ndërkombëtare.

Ai ka njohuri të drejtës penale për ato vepra penale që përfshihen në kompetencën lëndore të gjykatave për krime të rënda. Bën lidhjen e pjesës së përgjithshme me atë të posaçme të Kodit Penal, duke identifikuar rastin kur vepra penale është kryer në bashkëpunim, kur vepra penale nuk është përfunduar dhe ka shkak për uljen e dënimit nën minimumin e përcaktuar nga ligji, si dhe njuh kriteret e individualizimit të masave të dënimit. Gjithashtu, ai zotëron njohuri të rregullave procedurale të gjyqimit të shkurtuar apo të masave të sigurimit.

Subjekti i rivlerësimit harton vendime me strukturë të standardizuar. Vendimet përfundimtare të tij plotësojnë kërkesat e ligjit procedural penal. Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës në raport me pretendimet e ngritura nga palët gjatë gjyqimit. Analiza ligjore është e thjeshtë, duke paraqitur normën penale të zbatueshme dhe duke dhënë arsyet pse ajo zbatohet në rastin konkret. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Ndonjëherë, pjesa arsyetuese përmban fjali të përgjithshme për çështje të ndryshme të vendimmarrjes, siç është pjesa e caktimit të llojit dhe të masës së dënimit. Dispozitivi hartohet me tekst të qartë dhe të plotë, duke treguar sipas rastit të gjitha disponimet që shoqërojnë vendimin e fajësisë apo të pafajësisë gjer tek e drejta e ankimit për palët.

Struktura e vendimeve paraqitet në nivel mesatar, ku evidentohet edhe përsëritje e fakteve. Jepet informacion mbi çështje procedurale që nuk janë kundërshtuar nga palët, siç janë kompetenca lëndore e gjykatës dhe mënyra e procedimit me gjykim të shkurtuar. Paragrafët ndahen nga njëri - tjetri në pjesë, por metoda e ndarjes së tyre është e ndryshme, në disa raste me numra dhe në disa raste jo. Përgjithësisht organizimi formal i arsyetimit është me numërtim josolid (titujt nuk numërtohen me të njëjtën teknikë - janë përdorur në mënyrë jouniforme numrat romakë, shkronjat, numrat arabë, ndërsa paragrafët herë numërtohen dhe herë jo) dhe ndarja në pjesë me tituj nuk është konsistente.

Respektohen rregullat e drejtshkrimit. Fjalitë paraqiten me gjatësi normale dhe të kuptueshme. Dispozitivi është i qartë.

b) Lidhur me aftësinë organizative

Subjekti i rivlerësimit është eficient dhe efektiv, në drejtim të përfundimit të çështjeve në raport me numrin e çështjeve që atij i caktohen. Ai ka pasur ngarkesë të lartë sasiore. Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga subjekti i rivlerësimit ka qënë e shpejtë, në intervale kohore nga 2 ditë deri në 6 muaj e 13 ditë. Nuk është konstatuar ndonjë rast i cenimit të procesit të rregullt ligjor, por në 1 rast është konstatuar se gjyqtari nuk ka disiplinuar siç duhet sjelljen e palëve në proces. Subjekti i rivlerësimit i kushton rëndësi arsyetimit në kohë të shpejtë të vendimeve, ndonëse në 2 raste vendimet janë arsyetuar jashtë afatit 5 ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale. Megjithatë, vonesa në këto dy raste ka qënë me vetëm 1 ditë dhe justifikohen me natyrën komplekse të vendimeve të dhëna, si dhe nga fakti që në asnjë rast nuk është tejkaluar afati i ankimit në gjykatën më të lartë. Subjekti i rivlerësimit ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Gjatë gjyqimit, ai identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjyqimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, tek pretendimet fillestare të palëve, administrimi i provave, diskutimi përfundimtar gjer

tek shpallja e vendimit. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato përgjithësisht kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota.

c) Lidhur me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

Subjekti i rivlerësimit, nisur nga rezultati i ankesave për këtë subjekt dhe verifikimi i tyre për periudhën e rivlerësimit, ka treguar angazhim dhe etikë në punë. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, konstatohet se ndaj tij është paraqitur 1 ankesë nga Prokurori i Përgjithshëm në vitin 2015 për shkelje formale të ligjit në dhënien e një vendimi penal pafajësie. Kjo ankesë është verifikuar nga Inspektorati dhe i është regjistruar gjyqtarit për vlerësimin e tij etik dhe profesional, pasi u konstatua se vendimi i dhënë prej tij është ndryshuar tërësisht nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me arsyetimin se gjyqtari nuk ka vlerësuar drejt provat e shqyrtuara.

Nga shqyrtimi i dosjes për këtë subjekt nuk kanë rezultuar të dhëna në lidhje me ndikimin apo presion të jashtëm. Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur 2 ankesa në Komisionin e Pavarur Kualifikimit të cilat nuk paraqesin indice për veprime të kryera që cenojnë integritetin apo përbëjnë gjetje për paanësinë e saj gjatë ushtrimit të detyrës.

d) Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional

Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e tij. Në të gjitha rastet e vëzhguara nuk është konstatuar që ndonjë prej palëve të ketë paraqitur kërkesa për përjashtim të gjyqtarit dhe as kërkesa të vetë gjyqtarit për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes.

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Me përjashtim të 1 rasti, në të gjitha rastet, subjekti i rivlerësimit ka qënë pjesë e një trupi gjykues të formuar nga 5 gjyqtarë dhe ka bashkëpunuar me ta dhe administratën gjyqësore për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale. Po ashtu, nuk është konstatuar vonesë në arsyetimin e vendimit dhe depozitimin e dosjes gjyqësore në sekretari.

Subjekti i rivlerësimit, për tre vitet e fundit, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit, i ngarkuar vetëm me çështje penale të krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit, si dhe për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive. Ai ka marrë titullin Master i Shkencave në të Drejtën Publike dhe Ndërkombëtare Publike, pranë Shkollës Private të Arsimit të Lartë “Pavarësia” në vitin 2014.

Subjekti i rivlerësimit, për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së parë, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ai ka marrë pjesë në 10 trajnime.

Gjithashtu, ai ka qenë lehtësues në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës Magjistraturës në 2 aktivitete trajnuese me temë: “Refleksione rreth praktikës gjyqësore në lidhje me insitutin e bashkëpunimit”, të organizuar me dy sesione më 19 - 20 janar 2016 dhe më 10 - 11 Mars 2016.

Ai ka marrë pjesë edhe në 3 trajnime të tjera jashtë Shkollës së Magjistraturës.

Këto të dhëna tregojnë se ai ka marrë pjesë në 27 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ai ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit për krime të rënda.

Së fundmi, duhet evidentuar se subjekti i rivlerësimit për periudhën 06.12.2010 - 06.12.2015, ai ka qenë anëtar i KLD-së, i zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare. Në ushtrim të kësaj detyre, ai ka marrë pjesë në mbledhje dhe grupe pune të lidhura me administrimin e drejtësisë, ku ai vetë veçon tek deklaratimet e tij pjesëmarrjen në Komitetin Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Për sa më sipër unë, Genta Tafa (Bungo), në cilësinë e relatores së çështjes, pasi hetova raportin e KLD-së dhe denoncimet, nuk gjeta indice apo elementë që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit, propozoj për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Hallunaj : “I aftë”.

D. KONKLuzioni Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit e rivlerësimit, z. Dritan Hallunaj, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 01.08.2018.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

KRYESUES
Pamela QIRKO

ANËTAR
Suela ZHEGU

RELATOR
Genta TAFA (BUNGO)

Olsida GOXHAI
Sekretare gjyqësore